

3. Përfituesit që kalojnë procesin e parë të përzgjedhjes do të vizitohen në shtëpitë e tyre dhe/ose lokalet ku operon biznesi;
4. Përzgjedhja finale e përfituesve (Faza e dytë);
5. Nënshkrimi i kontratës për investim dhe bashkë-financim nga përfituesi me 15% të vlerës së grantit;
6. Bashkëfinancimi/transferimi i mjeteve financiare nga përfituesi në llogari bankare të Help-it;
7. Organizimi i trajnimeve për përfituesit e përzgjedhur;
8. Shpërndarja e pajisjeve tek përfituesi;
9. Mbështetja teknike për përfituesit e përzgjedhur;
10. Puna në komunitet nga përfituesit;
11. Monitorimi i vazhdueshëm i përfituesve.

## DETYRIMET KRYESORE TË PËRFITUESVE JANË

1. Të bashkë-financojnë me 15% të vlerës së grantit përmes transferimit bankar në llogari të Help-it;
2. Të regjistrojnë veprimtarinë biznesore si entitet ligjor në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës para marrjes së pajisjeve.
3. Në rast se biznesi është i regjistruar duhet punësuar ligjërisht të paktën një person;
4. Të shërbejë të paktën 15 orë pune në komunitet;
5. Të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Help.

## MARRJA E APLIKACIONEVE

Formën e aplikacionit mund ta:

1. Merrni në sesionin informues në komunën tuaj, ose,
2. Shkarkoni nëpërmjet ueb faqes Help në linkun [www.help-kosovo.org](http://www.help-kosovo.org) ose në Komunën tuaj.

## DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Data e fundit për aplikim është me 31 Mars 2016, e Enjte, ora 16:00

Aplikacionet e plotësuara dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen me postë në adresën:

Help Kosove  
Fahu postar Nr: 23  
10 000 Prishtinë  
Republika e Kosovës

[www.help-kosovo.org](http://www.help-kosovo.org)  
[facebook.com/HelpKosovo](https://facebook.com/HelpKosovo)

Ky projekt financohet nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, komunat partnere ndërsa zbatohet nga organizata Help.



## UDHËZUES PËR APLIKIM

### Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë

Kosovo, 2016

## RRETH PROJEKTIT

Projekti "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë" do të realizohet gjatë periudhës Shkurt 2016 deri Dhjetor 2017 në komunat: Prishtinë, Graçanicë, Gjakovë, Vushtrri, Gjilan, Pejë, Podujevë dhe Novobrdë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet në Kosovë me fokus kryesor fuqizimin ekonomik. Përderisa, qëllimi i veçantë është krijimi i vendeve të reja të punës përmes mbështetjes direkte me grante për biznese të vogla.

Nëpërmjet këtij projekti, planifikohet të shpërndahen grante, në formë të pajisjeve në mënyrë që përfituesit të mund të fillojnë apo rrisin biznesin e tyre. Vlera totale mesatare e një granti, për një përfitues, do të jetë 2,000.00 Euro, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 15%. Krahas pajisjeve, përfituesve do t'u ofrohen edhe trajnime profesionale dhe mbështetje teknike pasi të kenë pranuar pajisjet.

## KRITERET PËR APLIKIM

Për t'u kualifikuar për aplikim për fazën e parë, aplikuesi/ja duhet:

- Të jetë banor/e dhe me adresë të përhershme dhe të zhvillojë biznesin në njërin prej komunave të cekur më lartë;
- Të posedojë dokument të vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
- Të jetë i gatshëm për pjesëmarrje me bashkëfinancim në investim me shumën prej 15%;
- Të jetë: 1) biznes i ri (start-up), 2) të jetë biznes i regjistruar; 3) të jetë biznes operacional por i pa regjistruar;
- Të dorëzojë të kompletuar aplikacionin sipas thirrjes/të dhënave në aplikacion.

## KRITERET PËRJASHTUESE

Aplikuesi/ja do të përjashtohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në qoftë se:

1. Nuk posedon dokument të vlefshëm identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Nuk është banor/e i njërit prej komunave të cekura më lartë;
3. Dorëzon aplikacionin pas skadimit të afatit zyrtar;
4. Dorëzon më shumë se një aplikacion;
5. Në mënyrë direkte apo indirekte ofron, premtan, jep apo kërkon mito apo ndonjë përfitim tjetër, me qëllim të krijimit apo zhvillimit të biznesit.

Projektet që nuk financohen nga ky projekt janë:

1. Ide/biznese me karakter religjioz, politik;
2. Ide/biznese që në mënyrë direkte apo indirekte paraqesin rrezik për ambientin (ndot ambientin);
3. Ide/biznese të bazuara në tregti/shitblerje;
4. Ide/biznese që bien ndesh me kuadrin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës;
5. Bursa për studime, udhëtime studimore, pjesëmarrje në konferenca jashtë vendit;
6. Ide që kërkojnë pajisje që nuk janë në përputhje me veprimtarinë e biznesit;
7. Blerja e bagëtive, shpezëve dhe bletëve (përjashtuar pajisjet).

## KRITERET E PËRZGJEDHJES

Komisioni i përbashkët i përbërë nga zyrtarë të Help, zyrtarë komunal dhe ekspert të fushave do t'i shqyrtojnë të gjitha aplikacionet e pranuar. Para fillimit të procesit të përzgjedhjes në fazën e parë dhe në përputhje me objektivat e projektit, do të përcaktohen edhe kriteret ekonomike dhe sociale.

Kriteret ekonomike për të vlerësuar idetë e biznesit të aplikantëve janë:

- Shkathësitë e aplikantëve;
- Njohja e aktivitetit të propozuar;
- Konkurrenca;
- Kërkesat ligjore për të bërë biznes në Kosovë;

- Justifikimin e pajisjeve të kërkuara;
- Të ardhurat e pritshme
- Shpenzimet;
- Fitimin etj.

Kriteret sociale i referohen:

- Gjendjes sociale të përfituesve potencial dhe shkallën e ndjeshmërisë
- Vlerësimin e kushteve të jetesës
- Të ardhurat e disponueshme të familjes, dhe
- Fakte tjera relevante.

## PRIORITETET

Gjatë vlerësimit të aplikacioneve prioritet do të kenë:

1. Idetë e reja/inovative dhe me potencial për rritje dhe qëndrueshmëri;
2. Bizneset të cilat krijojnë më shumë vende të reja pune;
3. Kandidatet gra;
4. Komunitetet;
5. Personat me aftësi të kufizuara;
6. Personat me më pak mundësi punësimi.

## MËNYRA E PËRKRAHJES

Përkrahja financiare dhe bashkë-financimi do t'u shpërndahet përfituesve që i kanë plotësuar të gjitha kriteret e nevojshme dhe kanë fituar pikët maksimale në bazë të kriterëve të vlerësimit.

Përkrahja financiare dhe bashkë-financimi do të ndahet në pajisje (jo në para të gatshme). Shuma të cilën do ta ndajë Help për një përfitues është mesatarisht 2,000.00 Euro - këtu përfshihet edhe bashkë-financimi nga përfituesi me 15% të vlerës.

## VLERËSIMI I APLIKACIONEVE

1. Help do ta formojnë komision të pavarur i cili do t'i vlerësojë të gjitha aplikacionet;
2. Komisioni i pavarur në tërësi dhe i vetëm është përgjegjës për zgjedhjen e ideve fituese;
3. Komisioni i pavarur, në mënyrë të paanshme dhe në pajtim me kriteret e aprovuara do t'i vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar;
4. Help mbanë të drejtën që t'i refuzoj aplikacionet që nuk i përmbushin kriteret e aplikimit.

## PROCEDURAT E AKTIVITETIT PËRFSHIJNË

1. Aplikimi;
2. Vlerësimi dhe përzgjedhja fillestare (Faza e parë);